



Skuadra shkodrane e ka humbur ndeshjen e javës së katërt të kampionatit teksa është mundur 0-2 në Laç ndaj skuadrës vendase. Vllaznia e ka nisur ndeshjen me të njëjtin formacion si një javë më parë në Gjirokastrë dhe në fakt, minutat e para flasin për të. Në minutën e pestë Ribaj ka mundësi të rrezikojë portën vendase por nxitohet. Të njëjtën gjë bëjnë më pas edhe Çinari e Pjeshka. Por atë që se bëjnë shkodranët, do ta bënin vendasit. Në minutën e 21-të, Xhixha përfiton një top të mbetur në zonë dhe përballë Selimajt është i saktë në gjuajtje duke e dërguar topin në rrjetë. Vetëm kaq ka bërë Laçi në pjesën e parë ndërkohë që në minutat e fundit të saj janë tre raste të njëpasnjëshme të Vllaznisë me anë të Hasanit, Ribajt dhe Likës por pa rezultat. Kjo pjesë do të mbyllet 1-0 për kurbinasit. E dyta do niste mirë për kuqeblutë që në 10 minutat e para kontrollojnë lojën por në minutën e 58-të, Selimaj gabon në një grushtim duke e përplasur topin në trupin e Pjeshkës dhe ai do të perfundonte në rrjetë. Një gol i papritur që do prishte planet e Vllaznisë e cila në minutat e mbetura e ka të vështirë të dalë në lojën e saj ndonëse në fushë do jenë edhe Tafili, Vucaj e Kalaja. Minutat do kalonin dhe kuqeblutë nuk arrijnë të shënojnë dot. Përfundimisht 2-0 për Laçin ndërkohë që Vllaznia pëson humbjen e dytë në katër ndeshje duke mbetur kështu në kuotën e katër pikëve.

www.vllaznia.al